



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 19 tetor 2016

Numri i lëndës: 2014-37

Y.B.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 19 tetor 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Znj. Elka FILCHEVA – ERMENKOVA, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

PROCEDURA

1. Kryesuesja e Panelit, znj. Magda Mierzevska, ka marrë pjesë në diskutimet e kësaj lënde përmes komunikimit elektronik, në përputhje me nenin 13(3) të rregullores së punës së Panelit.
2. Ankesa është regjistruar me 29 shtator 2014. Z. Guénaél Mettraux është tërhequr dhe nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në pajtim me rregullën 12 par. 1(1) të rregullores së punës së Panelit. Për shkak të dorëheqjes së znj. Katja Dominik, anëtare e Panelit, pas shqyrtimit ajo u zëvendësua nga znj. Elka Filcheva-Ermenkova, anëtare zëvendësuese e Panelit, në përputhje me rregullin 14 par. 2 të rregullores së punës.
3. Me 4 shkurt 2015, Paneli ka vendosur të njoftonte rreth ankesës shefin e Misionit të EULEX-it (ShM), duke e ftuar atë të paraqiste

vërejtje me shkrim për ankesën. Po ashtu ishte vendosur që të shqyrtoheshin meritat e aplikacionit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij (në pajtim me rregullin 30, paragrafët 1 dhe 2 të rregullores së punës së Panelit).

4. Vërejtjet e ShM-së janë pranuar me 29 prill 2015. Më pas ato i janë komunikuar ankuesit për vërejtjet e tij shtesë.
5. Me 5 qershor 2015, ankuesi ka dërguar vërejtjet e tij, të cilat më pas i janë përcjellë ShM-së për informacion.
6. Në përgjigje të komenteve të ankuesve, ShM-ja ka paraqitur vërejtje shtesë me 31 gusht 2015.
7. Me qëllim të mbrojtjes së privatësisë dhe identitetit të ankuesit, Paneli ka vendosur, *proprio motu*, ta fshijë emrin e ankuesit nga ky vendim (në përputhje me nenin 46 të rregullores së punës së Panelit). Ai do të referohet si Y.B.

FAKTET

I. RRETHANAT E LËNDËS

8. Me 4 korrik 2014, një prokuror i EULEX-it i Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë ndaj N.K.-së në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Ai ishte akuzuar për krim të organizuar, vrasje të rëndë dhe vepra të ndryshme që lidhen me drogë.
9. Emri i ankuesit ishte paraqitur aktakuzë. Në veçanti u tha se N.K. “në bashkëkryerje” me ankuesin dhe disa persona të tjerë “ka organizuar, themeluar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe/ose drejtuar këtë grup të strukturuar dhe të organizuar kriminal (GOK) ose ka marrë pjesë në mënyrë aktive në këtë GOK, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do të kontribuojë në kryerjen e krimit të rëndë të vrasjes së rëndë të shefit të bandës rivale [RD] (...)”. Më tutje ishte pohuar se N.K. kishte “marrë pjesë në një sërë takimesh me [ankuesin dhe personat të tjerë], në Bosnjë dhe Hercegovinë. Pjesëmarrësit e këtyre takimeve formuan një grup të organizuar dhe strukturuar kriminal për të planifikuar, bërë komplot dhe vrarë [sic] shefin e bandës rivale R.D. (...)”. Për më tepër, aktakuza i është referuar dëshmisë së njërit prej dëshmitarëve, i cili ka pretenduar se ankuesi kishte pasur arsye që të urrente viktimën pasi ky i fundit ka qenë në marrëdhënie me gruan e ankuesit para martesës së saj. Prokurori gjithashtu ka kërkuar që ankuesi, së bashku me një numër të personave të tjerë, të thirret në shqyrtimin gjyqësor si dëshmitar.

10. Me 14 korrik 2014, gjatë seancës fillestare para Gjykatës Themelore të Prishtinës, prokurori i PSRK-së ka lexuar aktakuzën ndaj N.K. me përmbajtjen e përmbledhur më lartë. Kjo nuk është bërë publike në tërësi në atë kohë, por është raportuar gjerësisht nga shtypi për Ballkanin. Për më tepër, prokurori ka folur për mediat dhe i ka thënë Al Jazeera-së se ankuesi kishte bashkëpunuar me N.K. dhe kishte formuar një grup kriminal të organizuar me të dhe disa të tjerë.
11. Me 1 shtator 2014, ankuesi ka parashtruar një kërkesë konfidenciale në Gjykatën Themelore të Prishtinës për ta larguar emrin e vet nga aktakuza ndaj N.K.-së. Ai gjithashtu ka kërkuar qartësim publik se nuk ishte i dyshuar apo i pandehur në rastin në fjalë dhe ka kërkuar që prokurori të urdhërohet të hetoj nëse procesi në lëndë ishte dëmtuar përmes ofrimit të dëshmimeve të rreme apo mashtruese.
12. Me 2 shtator 2014, e gjithë aktakuza, siç duket që kishte rrjedhur, është publikuar në internet në faqen e internetit të Projektit të Raportimit të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
13. Me 9 shtator 2014, prokurori i PSRK-së ka paraqitur një përgjigje konfidenciale në Gjykatën Themelore. Ai ka kërkuar nga gjykata që të hedhë poshtë kërkesën e ankuesit si të papranueshme bazuar në mungesën e bazueshmërisë.
14. Me 12 shtator 2014, Gjykata Themelore e Prishtinës ka konfirmuar aktakuzën ndaj N.K. dhe ka dorëzuar çështjen për gjykim.
15. Me 22 shtator 2014, ankuesi ka parashtruar një kërkesë për marrjen e masave të mbrojtjes së dëshmitarëve në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Ai ka argumentuar se kishte qenë i kërcënuar dhe se gruaja dhe djali i tij kishin probleme psikologjike për shkak të publikimit të aktakuzës.
16. Me 4 dhjetor 2014, Gjykata Themelore e Prishtinës ka urdhëruar që paraqitja dhe publikimi i akuzave ndaj të pandehurit N.K. "tani e tutje nuk përfshin emrat e personave të cilët pretendohet nga Prokuroria se janë bashkë-autor pa aktakuzë" duke përfshirë formën me shkrim dhe me gojë. Gjykata u shpreh *ndër të tjera* se "perceptimi i aktakuzës nga ana e publikut duhet të ketë qenë shumë i dëmshëm për [ankuesin] pasi aktakuza e formuluar nga prokurori lehtë mund të kuptohet në një mënyrë që së paku ai akuzohet për lëndën". Gjykata e refuzoi kërkesën për masa mbrojtëse si të pabazuar dhe të i shpalli të gjitha kërkesat e të gjithë ankuesve të tjerë të papranueshme.
17. Shqyrtimi kryesor në rastin kundër N.K. është mbajtur me 16 janar 2015. Prokurori i PSRK-së bëri deklaratën e hapjes dhe iu referua ankuesit disa herë dhe aludoi në rolin e dyshuar të tij në komplotin për të vrarë R.D. Ai pretendoi *ndër të tjera* se "dëshmia në këtë rast do të tregoj se i pandehuri [N.K.] kishte drejtuar, organizuar dhe financuar [me ankuesin] vrasjen e R.D.-së". Prokurori po ashtu ka

paraqitur disa tabela që përshkruan grupin e pretenduar kriminal të organizuar për vrasjen e R.D.-së me një foto të ankuesit.

18. Procesi në lëndën ndaj N.D. është ende në pritje.
19. Ankuesi dhe dy persona të tjerë u arrestuan në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, me 25 janar 2016 me akuzat për pengim të drejtësisë (përpjekje për të ushtruar presion mbi një dëshmitar në rastin N.K.).

II. LIGJI PËRKATËS I ZBATUESHËM

Veprimi i përbashkët

20. Neni 2 dhe 3 i Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË (më tutje: Veprimi i Përbashkët), thotë si më poshtë:

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i në Kosovë do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

EULEX-i KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndhimë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

- (a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), përderisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;
...
- (d) të sigurojë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar/ekonomik dhe krimeve tjera të rënda të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi, përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë së bashku me hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit e Kosovës ose në mënyrë të pavarur, dhe përmes masave duke përfshirë, nëse ka nevojë, krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë;
- (e) kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit gjatë tërë procesit gjyqësor, veçanërisht në fushën e krimit të organizuar;
- (f) kontribuon në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit financiar;

Kodi i Procedurës Penale

Neni 221 Kërkesa për masë mbrojtëse apo anonimitet

1. Prokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi, i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues apo dëshmitari, në cilëndo fazë të procedurës mund t'i paraqesin gjyqtarit kompetent kërkesë me shkrim për masën mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet kur ka rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin apo anëtarët e familjeve të tyre.
2. Kërkesa përmban deklaratën e pretendimeve faktike. Gjyqtari kompetent evidencën kërkesën dhe deklaratën në një zarf të mbyllur, ndërsa përmbajtjet e tyre gjatë rrjedhës së procedurës kanë mundësi t'u qasen vetëm gjyqtari kompetent dhe prokurori i shtetit.
3. Pas marrjes së kërkesës, gjyqtari kompetent mund të urdhërojë masa të përshtatshme mbrojtëse për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin, e nëse ai e sheh të nevojshme para se të marrë vendim për kërkesën, thërret seancë dëgjimore të mbyllur për të dëgjuar informata shtesë nga prokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi, të dëmtuarit, dëshmitarët bashkëpunues ose dëshmitarët. Në rast të dorëzimit të kërkesës me të cilën kërkohet urdhër në pajtim me nenet 223 dhe 224 të këtij Kodi, gjyqtari kompetent thërret seancë të mbyllur dëgjimore.
4. Gjyqtari mund të urdhërojë masën mbrojtëse për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin kur ai konstaton se:
 - 4.1. ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin ose për anëtarin e familjes së tij; dhe
 - 4.2. masa mbrojtëse është e domosdoshme për të parandaluar rrezikun serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tij.
5. Prokurori i shtetit njoftohet menjëherë nga gjyqtari kompetent për çdo kërkesë të bërë nga i pandehuri, mbrojtësi, i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari dhe ai ka të drejtë të bëjë rekomandime e deklarata lidhur me faktet te gjyqtari kompetent në seancë dëgjimore, ose me shkrim nëse nuk është urdhëruar seancë dëgjimore nga gjyqtari kompetent.

LIGJI

Mandati i Panelit (Rregulla 25 § 1 e rregullores së punës)

21. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohet në Konceptin e Llogaridhënies së EULEX të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të jenë të garantuara nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
22. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
23. ShM ka pohuar se ngritja e aktakuzës dhe deklarata hyrëse e dhënë nga një prokuror janë pjesë dhe “elementi më tipik i imagjinueshëm” i

procedurave gjyqësore në një gjykatë të Kosovës. Prandaj sipas tij ankesa bie jashtë juridiksionit të Panelit dhe duhet të refuzohet si e papranueshme, në pajtim me rregulloren e punës dhe të OPLAN-it.

24. Ankuesi ka argumentuar se Paneli më herët kishte konstatuar se “veprimet e prokurorëve të EULEX-it të marra gjatë shqyrtimit të lëndën (...) bien në kuadër të mandatit të Panelit” dhe nëse “kryhen gjatë fazës hetimore të procedurës penale nuk duhet të konsiderohen pjesë e “procedurave gjyqësore”.
25. Paneli përsërit se sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
26. Paneli thekson se veprimet apo mosveprimet që i atribuohen prokurorëve gjatë fazës hetimore të procedurës penale nuk mund të konsiderohen se janë bërë në kuadër të “procedurave gjyqësore”. Veprimet e një prokurori të EULEX-it të marrë duke shqyrtuar një rast janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit të paktën deri në kohën kur aktakuza është ngritur në një gjykatë kompetente për të shqyrtuar meritat e një lënde (shih *Thaqi kundër EULEX-it*, nr. 2010-02, 14 shtatorit 2011, §§ 63-64).
27. Për më tepër, Paneli ka gjetur se nuk mund të përjashtohet që mund të jetë kompetent për të vlerësuar veprimet e prokurorëve të EULEX-it në hetimet penale edhe nëse ato i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor. Paneli do të jetë kompetent për të shqyrtuar veprimet e tilla dhe vendimet, për shembull, aty ku subjekti i veprimeve dhe vendimeve që i nënshtrohet rishikimit të tillë prek çështjet e të drejtave të njeriut. Paneli do të ndërhyjë vetëm nëse dhe kur akuzat për shkelje të të drejtave të njeriut që i ngarkohen prokurorit nuk janë adresuar plotësisht nga autoritetet gjyqësore kompetente (shih *E kundër EULEX-it*, 2012-17, 30 gusht 2013, § 22; *Z kundër EULEX-it*, 2012- 06, 10 prill 2013 § 34).
28. Në rastin konkret, Gjykata Themelore e Prishtinës ka urdhëruar me 4 dhjetor 2014 që paraqitja dhe publikimi i akuzave ndaj N.K. nuk duhet të përfshijë emrat e personave që ishin bashkë-autorë të dyshuar jo të akuzuar. Megjithatë, urdhri ishte dhënë vetëm pasi aktakuza ishte ngritur dhe ishte bërë i njohur për publikun dhe pasi prokurori në kontaktet e tij me media e kishte quajtur ankuesin “bashkë-autor” në krime dhe anëtar i një grupi të organizuar kriminal.
29. Paneli nuk mund të mos theksoj se në çfarëdo veprimi që kishte ndërmarrë Gjykata Themelore, atëherë ishte bërë tepër vonë për të ndryshuar veprimet e prokurorit dhe pasojat e tyre. Dëmi i pretenduar në të drejtat e ankuesit tashmë ishte bërë me paraqitjen e aktakuzës. Prandaj nuk mund të konkludohet se ndërhyrja në të drejtat e ankuesit ishte bërë në kuadër të “procedurave gjyqësore”, dhe as nuk ishin

adresuar plotësisht nga Gjykata Themelore (po ashtu shih *E ndaj vendimit të EULEX-it*, të cituar më lartë, § 24). Në bazë të asaj çfarë u përmend më sipër, Paneli gjen veten se ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën.

Shkeljet e pretenduara të nenit 2 dhe 3 të Konventës

Ankesat

30. Ankuesi ka argumentuar se duke publikuar emrin e tij në aktakuzë, edhe si bashkë-autor i dyshuar dhe si dëshmitar, prokuroria e ka zbuluar atë dhe familjen e tij ndaj rrezikut për jetën dhe sigurinë fizike. Prandaj ka pasur shkelje të nenit 2 dhe 3 të Konventës, ku thuhet si më poshtë.

Neni 2 E drejta për jetën

31. 1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

...

Neni 3 Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

32. Ankuesi ka pohuar që pavarësisht se prokurori i EULEX-it ka qenë në dijeni se rasti mund të krijoj shqetësime për mbrojtjen e dëshmitarëve, ai nuk ka ndërmarrë asnjë vlerësim të rrezikut dhe nuk ka ndërmarrë hapa për të ofruar sigurinë e dëshmitarit të mundshëm. Ai ka pretenduar se shpërndarja publike e aktakuzës kishte pasoja të mëdha në mirëqenien dhe sigurinë e tij dhe të familjes së tij. Ai kishte qenë i kërcënuar dhe gruaja dhe djali i tij kishte probleme psikiatrike për shkak të publikimit të aktakuzës.

Vlerësimi i Panelit

33. Paneli thekson se fjalia e parë e nenit 2 urdhëron autoritetet jo vetëm që të përmbahen nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, mirëpo që edhe të ndërmarrin hapat e duhur për të mbrojtur jetën e atyre brenda juridiksionit të tij (shih midis autoriteteve të tjera *L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998 par. 36, Raportet e Gjykimeve dhe vendimeve 1998- III).
34. Paneli konstaton se dëshmia që iu është paraqitur nuk është e mjaftueshme për të përfunduar se jeta e ankuesit apo e të afërmeve të tij ishin vënë në rrezik si pasojë e sjelljes që i ngarkohet EULEX-it. Prandaj Paneli konkludon se pjesa e ankesës që ka të bëjë me një shkelje të pretenduar të nenit 2 të Konventës nga ana e EULEX-it është haptazi e pabazuar dhe e papranueshme (krahaso p.sh. *W kundër EULEX-it*, nr. 2011-07, vendim mbi pranueshmërinë e datës 5 tetor 2012).

35. Sa i përket ankesës sipas nenit 3, Paneli thekson se keqtrajtimi duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie nëse ajo duhet të hyn në fushëveprimin e kësaj dispozite (midis shumë autoriteteve të tjera shih Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i datës 18 janar 1978, Seria A nr. 25, fq. 65, § 162; *Iwańczuk kundër Polonisë*, nr. 25196/94, § 50, 15 nëntor 2001).
36. Paneli pranon se ankuesi dhe familja e tij mund të ketë pësuar frikë dhe ankth pasi që mësuan rreth përmbajtës dhe shpërndarjes publike të aktakuzës. Megjithatë, Paneli nuk është i bindur se vuajtjet e tyre mendore kanë arritur nivelin minimal ashpërsie për të hyrë brenda fushës së nenit 3 të Konventës. Ankesat për këtë arsye janë të pabazuara dhe rrjedhimisht të papranueshme.

Shkelja e pretenduar e nenit 8 të Konventës

Ankesat

37. Ankuesi pohon se veprimet e prokurorit të EULEX-it përbëjnë shkelje të së drejtës së tij për jetën private që përfshin reputacionin e një personi. Prandaj EULEX-i ka shkelur nenin 8 të Konventës, i cili thotë si në vijim:

Neni 8 E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtë në respektimin e jetës së tij private (...) ...
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Parashtresat e palëve

38. Në parashttrimet e tij, ShM ka pranuar se ankuesi, së bashku me persona të tjerë, ishin çekur në aktakuzë si të dyshuar për pjesëmarrje në një grup të organizuar kriminal. Megjithatë, askund nuk ishte thënë se ai ishte i pandehur apo se ai kishte qenë i akuzuar për ndonjë vepër penale; atij i ishte dhënë vetëm statusi i dëshmitarit të rastit. Kur iu është referuar ankesës në aktakuzë, prokurori kishte gjetur të nevojshme që t'i referohej individëve përpos N.K.-së, në mënyrë që t'i jepej gjykatës një mundësi t'i dinte të gjitha faktet dhe rolet e këtyre individëve në krimet që ai ishte ngarkuar. Duke pasur parasysh marrëdhëniet e ankuesit me N.K., do të ishte e pamundur për prokurorin të paraqiste dëshmi pa iu referuar emrit të ankuesit në aktakuzë dhe gjatë gjyqimit. Në hapje të gjyqimit, duke i lexuar akuzat ndaj të pandehurit, prokurori nuk kishte përmendur emrin e ankuesit. Këtë e kishte bërë gjatë fjalës së tij hapëse, por kjo nuk ishte e ndaluar nga gjykata.

39. Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 8 të Konventës, ShM ka pohuar se prokurori kishte përmendur të dhënat personale të ankuesit në mënyrë që të bënte ndjekje efektive të N.K., të akuzuar për vrasje. Prandaj, veprimet e tij i kanë shërbyer një qëllimi legjitim të parandalimit të trazirave apo krimin dhe mbrojtjes së të drejtave të tjerëve, brenda kuptimit të nenit 8 të Konventës. ShM më tej ka argumentuar se përmendja e ankuesit dhe e të dhënave të tij personale ishin të nevojshme dhe të domosdoshme për shkak të ndjekjes penale efektive të N.K. Efektet e përmendjes së emrit të ankuesit po ashtu u zbuten edhe nga vendimi pasues i Gjykatës Themelore, që e kishte bërë të qartë se ai nuk ishte i akuzuar ose i pandehuri në gjykimin e N.K.-së. Për më tepër, ashtu siç përmendet shpesh në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ankuesi si një figurë publike duhej të tolerojë një nivel më të lartë të ndërhyrjes në jetën e tij private sesa një “njeri i zakonshëm”.
40. Ankuesi ka pohuar se aktakuza ka qenë e mbushur me sulme personale kundër tij të një serioziteti të mjaftueshme për të dëmtuar integritetin e tij personal. Është pohuar në mesin e akuzave të tjera shpifëse dhe pa mbështetje, se gruaja e ankuesit kishte qenë në një marrëdhënie me viktimën apo se kishte dëshmi se ankuesi kishte bashkëpunuar me “armikun” gjatë luftës. Vendosja e këtyre akuzave në një aktakuzë ka krijuar përshtypjen se ato kanë pasur ndikim. Akuza të tilla mund të jetë fatale në këtë mjedis të elektrizuar etnikisht në një vend të pas konfliktit.
41. Më tej ai ka argumentuar se as përmendja e tij si një bashkë-autor, e as marrëdhëniet e pretenduara personale të gruas së tij, nuk kanë shërbyer si qëllim legjitim i kryerjes së një hetimi efektiv, brenda kuptimit të nenit 8 të Konventës. Thjeshtë sepse dëshmia ishte e rëndësishme, nuk do të thoshte se duhej të deklarohet në aktakuzë. Edhe në qoftë se ajo ishte paraqitur në gjykatë, nuk kishte nevojë që prokurori t'i përmendte emrat e plotë të bashkë-kryerësve jo të akuzuar. Asgjë nuk do ta kishte penguar prokurorin që të përdorte pseudonime, që ishte një praktikë e përhapur në procedura serioze penale. Për më tepër, një motiv i dyshuar për krimin nuk ishte një fakt relevant që duhej të ishte deklaruar në aktakuzë.
42. Ankuesi ka pohuar se asnjë nga ndërhyrjet në jetën private të ankuesit të kryera nga prokurori nuk i kanë shërbyer qëllimit legjitim në mënyrë proporcionale. Edhe në qoftë se pranohet legjitimiteti i qëllimit për të ndërmarrë një hetim penal me ndjekje penale të mëtutjeshme për vrasje, kjo nuk do të thotë se ndërhyrja në të drejtat e ankuesit ishte e nevojshme në rrethanat e veçanta të rastiit. Ndërhyrja ishte shumë më e madhe se çfarëdo përfitimi i dukshëm, pra për këtë arsye nuk ishte proporcional me qëllimin e kërkuar.
43. Ankuesi ka pohuar se e drejta për të ruajtur reputacionin e dikujt e ka bërë tejet më të nevojshme mbrojtjen sesa që është argumentuar nga shefi i Misionit, siç duket nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Për më tepër, dëmtimi i reputacionit të dikujt

ndryshon në varësi të individit dhe pozitës së tyre. Në rastin në fjalë, emri i ankuesit ishte përmendur në aktakuzë në momentin kur ai lajmëroj pjesëmarrjen e tij në zgjedhjet presidenciale, kështu duke shkaktuar një dëm shumë më të madh të reputacionit të tij.

Vlerësimi i Panelit

44. Paneli thekson se, sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, reputacioni i një personi përbën pjesë të së drejtës së respektimit të jetës private dhe për këtë arsye është e mbrojtur nga neni 8 i Konventës (GjEDNj, *Chauvy dhe Të tjerë kundër Francës*, nr. 64915/01, § 70, KEDNj 2004- VI, *Pfeifer kundër Austrisë*, nr. 12556/03, § 35).
45. Megjithatë, në mënyrë që neni 8 të hyjë në veprim, sulmi ndaj nderit dhe reputacionit të personit duhet të arrijnë një nivel të caktuar të seriozitetit (*ndër të tjera shih A. kundër Norvegjisë*, nr. 28070/06, § 64, 9 prillit 2009; *Sidabras dhe Džiautas kundër Lithuanisë*, nr. 55480/00 dhe 59330/00, § 49, KEDNj 2004- VIII). Paneli konstaton se ka pasur një numër të rasteve lidhur me deklaratat e bëra gjatë një hetimi ose procedimeve gjyqësore, ku Gjykata ka konstatuar se ka pasur ndërhyrje në të drejtën e ankuesit në jetën private (për shembull shih *Sanchez Cardenas kundër Norvegjisë*, nr. 12148/03, § 33, 4 tetor 2007; *Mikolajová kundër Slovakisë*, nr. 4479/03, § 57, 18 janar 2011).
46. Në rastin konkret, u la të nënkuptohet në aktakuzë se ankuesi ka marrë pjesë në një grup të krimit të organizuar, në mënyrë që ta vrasë një "shef të grupit kriminal rival", që përbën një vepër të rëndë penale (shih par. 9 më lartë). Një deklaratë e formuluar në kushte të tilla e bërë në një padi zyrtare duket se përbën një pohim se ankuesi ka kryer krimet në fjalë, edhe pse ai nuk është akuzuar në procedurën penale në fjalë (edhe në qoftë se ai ishte arrestuar në Bosnjë dhe Hercegovinë në lidhje me një vepër tjetër penale). Në vende të tjera, është lënë të nënkuptohet se gruaja e ankuesit kishte qenë "në një marrëdhënie" me viktimën para se ajo të ishte martuar me ankuesin (shih par. 9 më lartë). Zbulimi i aspekteve intime nga jeta private e ankuesit dhe e gruas së tij, qoftë e vërtetë apo e pavërtetë, gjithashtu përbën ndërhyrje në të drejtën e ankuesit në respektimin e jetës së tij private.
47. Sa i përket çështjes nëse ndërhyrja ishte "në përputhje me ligjin", Paneli konstaton se nuk është kontestuar as nga palët e as nga Gjykata Themelore e Prishtinës në vendimin e saj të datës 4 dhjetor 2014. Paneli nuk sheh arsye për të pranuar ndryshe nga kjo.
48. Detyrë e Paneli është të përcaktohet nëse ndërhyrja i ka shërbyer ndonjë qëllimi legjitim dhe nëse ajo ka prekur ekuilibrin e drejtë midis interesave të përgjithshëm të komunitetit dhe interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit (shih *Beyeler kundër Italisë* [GC], nr. 33202/96, § 107, KEDNj 2000). Duke u kthyer në kriterin tjetër në nenin 8 § 2, Paneli

është i përgatitur të pranoj se ndërhyrja ka ndjekur qëllimet legjitime të renditura në nenin 8 § 2, sidomos për parandalimin e trazirave apo krimit.

49. Prandaj pyetja mbetet nëse është arritur një ekuilibër i drejtë mes interesave konkurruese publik dhe private në këtë rast. Në parashtrimet e tij, ShM ka argumentuar se emërtimi i ankuesit në aktakuzë ka qenë i domosdoshme për t'i paraqitur Gjykatës Themelore të gjitha faktet dhe për të filluar një ndjekje penale efektive ndaj N.K.-së. Paneli nuk është bindur nga këto argumente. Paneli pranon se mund të ketë qenë e pamundur për të paditur N.K.-në për krim të organizuar dhe diskuton rastin ndaj tij pa iu referuar personave të tjerë të përfshirë. Megjithatë, nga formulimi i akuzës duket se pa i shërbyer ndonjë qëllimi në rastin kundër N.K., prokurori kishte pohuar faktin se ankuesi kishte kryer një krim të rëndë. Askund në aktakuzë nuk është bërë e qartë se në fakt ankuesi nuk është një i dyshuar dhe se nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij. Përkundrazi, ai në mënyrë të qartë quhet "bashkë-autor" dhe "shef i bandës" (shih paragrafin 9 më lartë). Këto deklarata, sipas mendimit të Panelit, shkojnë shumë më tej sesa thjeshtë përshkrimi i gjendjes së dyshimit.
50. Gjykata Themelore e Prishtinës gjithashtu vuri atë në rendin e tij në datën 4 dhjetor 2014, kur deklaroi se "aktakuza e formuluar nga prokurori lehtë mund të kuptohet në një mënyrë që së paku ai është i akuzuar në atë lëndë" (shih par. 15 më lartë). Për më tepër, Paneli konstaton se nuk duket të jetë asnjë arsye se pse parashtruesi i ankesës dhe "bashkë-autorët" e tjerë të dyshuar duhet të jenë të përmendur me emra në këtë fazë të procedurës dhe pse kjo nuk mjafton për t'iu referuar atyre në terma më të përgjithshme (për shembull "personat e tjerë") ose duke përdorur inicialet e tyre.
51. Po ashtu, Paneli nuk sheh arsye bindëse pse përmendja e jetës personale të bashkëshortes së ankuesit si arsye e pretenduar e "urrejtjes" së tij ndaj viktimës do të ketë ndonjë rëndësi të madhe në rastin kundër N.K.-së.
52. Në përgjithësi, nuk janë paraqitur argumente për të treguar se rasti i ndjekjes penale ndaj N.K.-së nuk mund të ishte iniciuar në mënyrë efektive me përshkrimin e fakteve që paraqesin përfshirjen e pretenduar të ankuesit në veprat në të cilat N.K. besohet të ketë qenë i përfshirë në një mënyrë më ndryshe.
53. Paneli konstaton se portretizimi i mësipërm i ankuesit në një akt prokurorial autoritativ në një mënyrë që ka treguar më shumë siguri sesa mundësi ose dyshim nga ana e prokurorisë, ishte e aftë për të stigmatizuar atë dhe për të pasur ndikim të madh në jetën personale dhe reputacionin e tij.
54. Në bazë të asaj që u përmend më sipër, Paneli konstaton se ndërhyrja në të drejtën e ankuesit në respektimin e jetës së tij private nuk ishte mjaftueshëm e justifikuar në rrethanat dhe si i tillë është në

disproporcion me qëllimet legjitime të ndjekura. Prandaj kjo mundësoj shkeljen e nenit 8 të Konventës.

Shkeljet e pretenduara të nenit paragrafëve 1 dhe 3 të nenit 6 të Konventës

Ankesat

1. Ankuesi ka pohuar se duke pretenduar publikisht që ankuesi ishte pjesë e një organizate kriminale, prokurori i EULEX-it ka shkelur nenin 6 § 2 të Konventës. Ankuesi shton se në shkelje të nenit 6 § 3 të Konventës ai kurrë nuk ishte informuar zyrtarisht për natyrën dhe shkakun e akuzave ndaj tij, pavarësisht se ishte akuzuar në mënyrë efektive për vrasje. Për më tepër, ishte pohuar se ankuesi ishte përgjegjës për vrasje, por atij i ishte mohuar e drejta e tij për të pasur qasje në drejtësi, për të mbrojtur veten dhe të ushtrojë të drejtat e tij sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Në këto dispozita në pjesët e tyre përkatëse thuhet si në vijim:

Neni 6 E drejta për një proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj.

....

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
(a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

....

Parashtresat e palëve

2. Shefi i Misionit ka pohuar se, në funksion të parimit të pavarësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, nuk do të ishte e përshtatshme që ai të komentojë mbi zbatueshmërinë dhe shkeljen e mundshme të nenit 6 § 2 të Konventës. Ai thjesht ka pranuar se, në vendimin e tij të datës 4 dhjetor 2014, Gjykata Themelore e Prishtinës duket se kanë gjetur këtë dispozitë të zbatueshme.

3. Ankuesi ka argumentuar se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur se koncepti “akuza” duhet të jetë “substancial”, e jo “formal” dhe se “akuza” ishte përcaktuar si “një njoftim zyrtar i dhënë një individ nga autoriteti kompetent rreth një akuze që ai ka kryer vepër penale”. Edhe pse ai nuk ishte akuzuar zyrtarisht, përfshirja e ankuesit në aktakuzë, si një bashkë-autor në vrasjen e N.D.-së në mënyrë të qartë ka hyrë në këtë përkufizim të

akuzës. Ai konsideron se leximi publik i aktakuzës kishte lënë përshtypjen se fajësia e tij i ishte nënshtruar një lloj konfirmimi gjyqësor. Megjithatë si një konspirator i pa akuzuar ai nuk kishte asnjë mundësi për të kundërshtuar këtë aktakuzë.

Vlerësimi i Panelit

Paneli tashmë ka gjetur shkelje të nenit 8 të Konventës, që ishte bazuar në të njëjtat fakte, duke formuar bazën për shkeljen e pretenduar të nenit 6. Andaj Paneli konstaton si të panevojshme për të shqyrtuar nëse ka pasur shkelje të kësaj të fundit. Prandaj e deklaron këtë ankesë të papranueshme.

Shkeljet e supozuara të neneve 10 dhe 11 të Konventës

Ankesat

55. Ankuesi pohon se EULEX-i ka shkelur të drejtën e tij për të marrë pjesë lirisht dhe në mënyrë të drejtë në zgjedhje demokratike duke shkatërruar dinjitetin dhe reputacionin e tij, rrjedhimisht karrierën e tij politike. Ankuesi thirret në nenet 10 dhe 11 të Konventës, që në pjesët e tyre përkatëse thuhet si në vijim:

Neni 10 Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë.

....

Neni 11 Liria e tubimit dhe e organizimit

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

56. Ankuesi ka argumentuar se në bazë të nenit 10 ai kishte të drejtë në lirinë e shprehjes, e cila përfshinë shprehjet politike dhe të drejtën për të shprehur lirshëm idetë e tij për të ardhmen e vendit të tij si president i saj. Në mënyrë të ngjashme, neni 11 i Konventës ka garantuar lirinë e tubimit dhe të organizimit, duke përfshirë të drejtën për të formuar parti politike. Shkelja e kësaj të drejte duhet të përfshijë secilin veprim ekzekutiv që tenton të heshtë idetë politike të një individi, e tillë si përfshirja e emrit të ankuesit në aktakuzë.

Vlerësimi i Panelit

57. Paneli tashmë ka pranuar se përfshirja e emrit të tij në aktakuzë si bashkë-autor i dyshuar në vrasje mund të ketë dëmtuar reputacionin e tij dhe rrjedhimisht pozitën e tij politike. Megjithatë Paneli nuk vëren ndonjë tregues se kishte ndonjë ndikim në të drejtat e tij sipas nenit

10 dhe 11 të Konventës. Prandaj i gjen këto ankesa të papranueshme, pasi qartazi janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

PANELI NJËZËRI

1. *Shpall* ankesat sipas neneve 6, 10 dhe 11 të Konventës të papranueshme, pasi qartazi janë të pabazuara;
2. *Gjen* një shkelje të nenit 8 të Konventës;

dhe

DEKLARON

se në bazë të gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe ligjit, Paneli gjen të përshtatshme të bëjë rekomandime për ShM-në, dhe

REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME KORRIGJUESE:

- a. ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë një shkelje të të drejtave të ankuesit që i ngarkohen veprimeve të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv;
- b. ShM-ja duhet t'i ofroj një kopje të këtij vendimi prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse. Kjo duhet të shërbej që të informohen prokurorët e EULEX-it rreth natyrës së përgjithshme të obligimit që çështjen më të rëndësishme ta kenë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive jo vetëm të të dyshuarve dhe të akuzuarve, por edhe të personave të përfshirë në lëndët që ata i hetojnë.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese